

ARGUMENTUM

news opinion analysis



Hapet baza ajrore taktike e NATO-s në Shqipëri

- Nëse duam paqe, ne duhet të përgatitemi për luftë
- Serbia dhe sfida e stabilitetit të Malit të Zi
- Ukraina/ Papa Françesku: Mos kini turp të negocioni!

Të dashur lexues dhe ndjekës të Argumentum.al,

Argumentum.al tashmë nga muaji prill 2022 vjen në versionin e një reviste të përmuajshme politike-diplomatike të cilën mund ta shfletoni online. Ky botim mujor ofron një kombinim të qartë të lajmeve në vend, rajon dhe botë, si dhe opinioneve dhe analizave për ngjarjet e zhvilluara përgjatë një muaji. Duke falënderuar secilin prej jush për vëmendjen dhe besimin ndaj medias tonë, ju premtojmë që do të vijojmë të sjellim për ju analizat objektive mbi zhvillimet kryesore në Vend, Rajon, Europë dhe në Botë.

Argumentum.al përpiqet të jetë burim autoritar i gazetarisë me analiza dhe komente mbi marrëdhëniet ndërkombëtare,

politikën botërore dhe një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi globale duke sjelle materiale ekskluzive. Kjo falë edhe kontributit të disa prej emrave të njohur të politikës dhe publicistikës shqiptare dhe bashkëpunorëve të tjerë vendas dhe të huaj. Në të njëjtën kohë Argumentum.al është e hapur për komente e mendime të lexueseve të saj. Lexoni falas mbi çështjet e brendshme dhe ndërkombëtare në revisten Argumentum.al në shqip dhe anglisht!

“Argumentum”, një proces intelektual ...

Marjana DODA
Kryeredaktore

Përmbajtja

03 SPECIALE

- Hapet baza ajrore taktike e NATO-s në Kuçovë.

07 OP/ED

- Nëse duam paqe, ne duhet të përgatitemi për luftë.

09 JO VETEM LAJM

- 16 vite nga tragjedia e Gërdecit.

- Bujar Spahiu rizgjidhet në krye të KMSH-së: Do të punoj me ngulm për forcimin e ndjenjës kombëtare e atdhe-dashurisë ndër myslimanët e Republikës së Shqipërisë!

12 FOKUS

- Serbia dhe sfida e stabilitetit të Malit të Zi.

14 POLITIKË

- 580-vjetori i Besëlidhjes së Lezhës, Presidenti Begaj pret delegacionin arbëresh: Bashkimi është forca përballë çdo kërcënimi.

16 REALPOLITIK

- Leyen dhe stabilokracia! Polonia rikthehet në Euro-Atlantizëm ! Tripalëshi i Vajmarit në Berlin! "Jo murit me kokë, Albin"!

19 BOTA

- Shefi i Pentagonit, Lloyd Austin: "Nëse Ukraina humbet,

NATO do të luftojë Rusinë".

- Papa për luftën në Ukrainë: Mos kini turp të negocioni!

ENGLISH EDITION

22 ENGLISH TOP NEWS

- NATO completes modernisation of major airbase in Albania.

23 IN FOCUS

- Trump's son-in-law to carry two major tourism projects in Albania and Serbia.

25 BALKAN OVERVIEW

- Much Ado about Nothing? Party positioning in North Macedonia and what to expect from the 2024 elections.

27 REALPOLITIK

- Just to "keep Kola busy"! Geopolitical interests over democratic values! EU Summit for Ukraine and Bosnia! A routine visit, not a breaking point!

30 GLOBAL

- Vladimir Putin wins Russian presidential election with 87.29% of the vote.

- War in Gaza a graveyard for humanitarian law, top EU diplomat says.

SPECIALE

Hapet baza ajrore taktike e NATO-s në Kuçovë

Ndërsa aleanca e NATO-s feston këtë vit 75-vjetorin e krijimit dhe Shqipëria 15-vjetorin e anëtarësimit të saj në këtë aleance ushtarake, pikërisht në Shqipëri, u hap zyrtarisht të hënën e 4 marsit 2024 baza ajrore taktike e NATO-s. E vendosur rreth 80 kilometra në jug të Tiranës, baza ajrore e Kuçovës do t'i shërbejë Shqipërisë dhe do të mbështesë logjistikën, operacionet ajrore, dhe stërvitjet e Aleancës. NATO financoi përmirësimin e bazës me rreth 50 milionë euro.

Në këtë aktivitet morën pjesë krerët më të lartë të shtetit dhe përfaqësues të Aleancës. Pjesë e ceremonisë ishin presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, Lindita Nikolla, kryeministri Edi Rama, ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, Niko Peleshi dhe ministra të tjerë të kabinetit qeveritar të Shqipërisë, ministri i Mbrojtjes i Kosovës, Ejup Maqedonci, ministrja e Mbrojtjes e Maqedonisë së Veriut, Slavjanka Petrovska, ministri italian i Mbrojtjes, Guido Crosetto, përfaqësuesi ushtarak i Turqisë në NATO, gjenerali Yüksel Kayhan, përfaqësues të NATO-s dhe vendeve anëtare të Aleancës, si dhe ambasadorë, përfshirë edhe ambasadorin

turk në Tiranë, Tayyar Kağan Atay.

Në nisje të ceremonisë, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi deklaroi se ky është investimi më madhor i NATO-s në Shqipëri dhe do të shërbejë si një “bazë ajrore taktike dhe operacionale” për Aleancën në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe më gjerë.

“Sot deklarojmë zyrtarisht hapjen e bazës së NATO-s në Kuçovë. Mbi këtë pistë, MIG-u i fundit ka fluturuar pothuaj 19 vjet më parë. Erdhi koha që në Kuçovë të ndihet jehona e avionëve të NATO-s, mbrojtësve të qiejve tanë, në dekadën më të rrezikshme të historisë moderne të rajonit dhe të mbarë Europës”, nënvizoi Peleshi.

Ministri shtoi se “ndjenja e krenarisë që sot provojmë është mëse e ligjshme, jo vetëm për rezultatin e dukshëm të një ekipi të jashtëzakonshëm ekspertësh dhe teknikësh që kanë punuar ditë e natë për ringritjen e kësaj baze, por edhe për faktin se një vend i vogël si Shqipëria ka nderin dhe privilegjin t'i ofrojë Aleancës këtë aset të vyer në skemën e saj të mbrojtjes kolektive”.

“Helikopterët ‘Black Hawk’ dhe dronët ‘Bayraktar’, të siguruar me mbështetjen e Shteteve të





Bashkuara të Amerikës dhe Republikës së Turkiyes, janë aktualisht në gatishmëri të plotë për të nisur fluturimin nga kjo bazë. Numri i tyre do të shtohet ndjeshëm, në një të ardhme të afërt dhe për këtë qëllim po punohet fort”, nënvizoi Peleshi.

Presidenti Begaj: NATO është e vendosur të mbrojë lirinë dhe sigurinë e aleatëve

Në fjalën e tij presidenti Begaj u shpreh se kjo bazë është rezultat i bashkëpunimit, solidaritetit, bashkërendimit dhe koordinimit midis aleatëve dhe i vëmendjes që Shqipëria i kushton sigurisë dhe mbrojtjes.

“Nga kjo bazë, ne së bashku dërgojmë mesazhin e fuqishëm të paqes dhe dëshmojmë se NATO është e vendosur të mbrojë lirinë dhe sigurinë e aleatëve, duke garantuar mbrojtje kolektive”, u shpreh Begaj.

Kreu i Shtetit i shprehu mirënjohjen të gjithë aleatëve në NATO, veçanërisht partnerit strategjik, SHBA-së, për mbështetjen e paçmuar që i kanë dhënë Shqipërisë në rrugëtimin euroatlantik.

“Detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi në NATO dhe nga procesi i anëtarësimit në BE janë natyrshëm edhe interesat strategjike të Shqipërisë. Baza ajrore taktike e NATO-s, e ngritur në Kuçovë, ku historia takohet me modernen, simbolizon një urë ku e shkuara dhe e tashmja bashkohen për të siguruar një të ardhme të sigurt. Ky zhvillim nuk është vetëm një arritje ushtarake, është simbol i qartë i angazhimit tonë për të mbrojtur vendin, dhe parimet e vlerat demokratike që ne, si aleatë të NATO-s, ndajmë së bashku”, shtoi ai.

Sipas Presidentit, “Shqipëria dhe Kuçova nuk u zgjodhën rastësisht. Kjo dëshmon vlerësimin dhe besimin që aleatët kanë te Shqipëria, si një part-

nerë e denjë dhe e përkushtuar. NATO nëpërmjet këtij investimi, tregon se Shqipëria ka një rëndësi strategjike për Aleancën. Është një investim për të forcuar kapacitetet, planet, burimet dhe infrastrukturën e aleancës”.

Kryeministri Rama: Baza Ajrore Taktike e NATO-s, në Kuçovë forcon angazhimin e Shqipërisë për paqe dhe siguri në rajon

Kryeministri Rama u shpreh se baza është një tjetër element sigurie për rajonin e Ballkanit Perëndimor i cili tha ai e “dimë mirë se është një rajon jo i pa rrezikuar nga kërcënimi dhe ambiciet neo-imperialiste të Federatës Ruse”.

“Unë jam posaçërisht i lumtur sot që një punë e nisur prej shumë kohësh arriti të përfundojë dhe këtu bashkë me ne janë edhe plot miq, partnerë, aleatë, të cilët do të doja të falënderoja, në mënyrë të posaçme ministrin e Mbrojtjes së Italisë, i cili ka ardhur edhe me disa avionë luftarakë me vete dhe nga ana tjetër, do doja të falënderoj miqtë dhe aleatët tanë të paçmueshëm turq të cilët për thujse tre dekada e mbajtën gjallë frymën e kësaj baze, e cila sot është tërësisht e transformuar dhe e gatshme si një bazë e re taktike e NATO-s me një rëndësi që i tejkalon kufijtë e



Shqipërisë. Një bazë e cila është një tjetër element sigurie për rajonin tonë të Ballkanit Perëndimor i cili e dimë mirë se është një rajon jo i pa rrezikuar nga kërcënimi dhe ambiciet neo-imperialiste të Federatës Ruse”, tha ne fjalën e tij Kryeministri Rama.

Rama theksoi se riaktivizimi i këtij aeroporti ushtarak është njëkohësisht edhe pjesë e ripërtëritjes dhe rritjes së mëtejshme cilësore të flotës ajrore. “Dy helikopterët e rinj Black Hawk si dhe dronët Bayraktar janë pjesë e një rritjeje që do të vazhdojë”, tha Rama.

“Dua t’i shpreh një falënderim të posaçëm të gjithë atyre që kontribuuan duke filluar, sigurisht nga aleatët tanë të NATO-s me shpresën dhe besimin që kjo bazë e re taktike ajrore e NATO-s do të shoqërohet në vitet në vijim nga baza e re detare e NATO-s në Porto Romano (Durrës), gjë për të cilën po punojmë ngushtësisht me NATO-n dhe jemi shumë besimplotë se së shpejti do të mund t’i gëzohemi lajmit të përfshirjes së këtij projekti në planet e Aleancës”, u shpreh Rama.

Gjenerali Yüksel Kayhan: “Türkiye dhe Shqipëria si dy aleatë të NATO-s kanë bashkëpunim të ngushtë”

Përfaqësuesi ushtarak i Turqisë në NATO, Gjenerali Yüksel Kayhan, theksoi se uron që Baza Ajrore e Kuçovës të jetë një ogur i mirë për Shqipërinë dhe Aleancën.

Kayhan tha se Shqipëria është zhvilluar në çdo fushë pothuajse në vitet e fundi dhe theksoi se mes Turqisë dhe Shqipërisë ekziston një miqësi dhe vëllazëri e thellë historike për më shumë se 500 vjet.

“Türkiye dhe Shqipëria si dy aleatë të NATO-s kanë bashkëpunim të ngushtë për sigurinë, paqen dhe stabilitetin rajonal. Forcimi i Turqisë si një partner i rëndësishëm në aspektin ushtarak



ka një rëndësi kritike për forcën dhe efikasitetin e Aleancës në rajon”, u shpreh Kayhan.

Komandanti i qendrës së operacioneve ajrore të kombinuara të NATO-s, gjeneral Juan Pablo Sanchez De Lara, u shpreh se Shqipëria është integruar plotësisht në sistemin e mbrojtjes ajrore të NATO-s.

“Përrurimi i Bazës Ajrore të Kuçovës dëshmon se aleanca jonë me një qasje 360 gradë është e angazhuar mjaft në rajon. Jam i sigurt që kjo bazë ajrore do të jetë në përputhje me standardet e NATO-s do të përmirësojë ndërveprueshmërinë, rezistencën dhe bashkëveprimin në kuadër të Aleancës. Së bashku do të qëndrojmë gjithmonë krahu njëri-tjetrit”, tha De Lara.


Ministri italian i Mbrojtjes Guido Crosetto, në ceremoni tha se sot kremtojnë një moment domethënës. Crosetto theksoi se përrurimi i bazës vjen në një moment ndryshimesh të thella dhe të shpejta në arenën ndërkombëtare dhe sipas tij përrurimi është një pikënisje për bashkëpunime dhe nisma të përbashkëta në të ardhmen.

Gjatë ceremonisë u realizuan edhe ekspozime dhe fluturime të mjeteve ajrore si avionë, helikopterë dhe dronët turq “Bayraktar” TB2, dronë që tashmë janë pjesë e Forcave të Armatosura të Shqipërisë.

Pas fjalimeve në ceremoni, dy avionë luftarakë të SHBA-së F-16 dhe dy avionë luftarakë F-35 nga Baza Ajrore Aviano në Itali fluturuan ndërsa dy Eurofighters u ulën.

Shqipëria si një vend anëtar i NATO-s u zgjodh nga Aleanca për ndërtimin e një baze taktike ajrore në rajon dhe në janar të vitit 2022 filloi puna në terren për realizimin e projektit për modernizimin e Bazës Ajrore në Kuçovë, e cila ka shërbyer për disa dekada si bazë ajrore, për ta





shndërruar atë në një bazë taktike të NATO-s. Sipas autoriteteve shqiptare, nga NATO janë të investuara afërsisht 50 milionë euro dhe më shumë se 5 milionë euro janë të investuara nga qeveria shqiptare. Projekti në fjalë përfshinte punimet mbi infrastrukturën për kontrollin dhe sigurinë e fluturimeve, pistën, rrugët lidhëse, si dhe asetet e tjera ndihmëse.

Zyrtarët thanë se baza e re ajrore do të shërbejë si një qendër moderne e operacioneve, për trajnimin dhe pritjen e një sërë avionësh luftarakë.

Baza e Kuçovës, e cila do të përfaqësojë infrastrukturën për aktivitetet e NATO-s në Ballkanin Perëndimor dhe për operacionet mbështetëse në zonën më të gjerë të Mesdheut Lindor dhe rajonit të Detit të Zi.

Baza e Kuçovës synohet të përdoret, nëse është e nevojshme, për pritjen e avionëve luftarakë italianë dhe grekë që kanë për detyrë mbrojtjen e hapësirës ajrore shqiptare në kuadër të Sistemit të Integruar të Mbrojtjes Ajrore dhe Raketore të NATO-s.

Gjithashtu, forcat ajrore italiane dhe greke mbulojnë Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut dhe të dy vendet, si dhe Shqipëria, duhet të kenë një bazë ku mund të zbarkojnë luftëtarët aleatë.

Kujtojmë se në stërvitjet e mëdha të NATO-s në 2021 dhe 2023 u kontrollua dislokimi i shpejtë i ushtrisë amerikane nga pjesa kontinentale e SHBA-së në Detin Mesdhe. Në këto aktivitete, një pozicion i veçantë iu dha Shqipërisë, ku amerikanët zbarkuan në portin e Durrësit dhe përdorte terrenin e Bizës për stërvitje luftarake. Në të ardhmen, për stërvitje të tilla, duket se Kuçova do të jetë baza kryesore për pritjen e forcave amerikane dhe aktiviteteve të tyre në Ballkan.

KUÇOVA DJE DHE SOT

Baza ajrore e qytetit të Kuçovës, që dikur mbante emrin Stalin për nder të diktatorit të Bashkimit Sovjetik, nisi të ndërtohej në fillim të viteve 1950 nga sovjetikët, të cilët ndihmuan në ngritjen e saj dhe trajnimin e pilotëve. Skuadrilja e parë me avionë luftarakë u krijua në vitin 1955, thuajse në të njëjtën kohë me krijimin e Paktit të Varshavës.

Në kohën kur baza u përfundua në vitin 1955, marrëdhëniet midis Beogradit dhe Moskës po përmirësoheshin. Në fillim të viteve 1960, udhëheqja shqiptare, e zhgënjyer nga destalinizimi i BRSS, iu drejtua Kinës.

Megjithatë, gjatë rebelimit të vitit 1997, civilët hynë në bazë dhe vodhën gjithçka që mund të hiqej, duke bërë që kjo bazë të degradohej. Por tashmë, Baza e Kuçovës pas këtij investimi nga NATO është kthyer në një bazë moderne me dy pista 2.853 dhe 2.500 metra të gjata.

Baza e Kuçovës është projekti më i madh i NATO-s në Shqipëri në dekadën e fundit. Puna e rinovimit filloi me një ceremoni themelimi në 2019 dhe përfshin përmirësime dhe rinovime në kullën e kontrollit, pistat, hangarët dhe objektet e magazinimit. Punimet u financuan nga Programi i Investimeve në Siguri i NATO-s (NSIP) i cili mbulon projektet kryesore të ndërtimit të mbrojtjes në vendet aleate.



NËSE DUAM PAQE, ne duhet TË PËRGATITEMI PËR LUFTË

CHARLES MICHEL

President i Këshillit Evropian

Ishte ora 3:30 e mëngjesit të datës 24 shkurt 2022 kur u zgjova nga zhurma e ziles së telefonit tim. Informatat e panumërta të inteligjencës që paralajmërojnë për një pushtim rus të Ukrainës nuk mund t’ju përgatisin kurrë për momentin. Duke dëgjuar zërin e rëndë të Presidentit Zelenskyy përmes telefonit “bombat po bien mbi ne, është një pushtim i plotë”, e dija se e gjithë rregullimi i sigurisë pas Luftës së Dytë Botërore kishte ndryshuar përgjithmonë. BE-ja duhej të ndryshonte me të dhe shpejt.

Brenda pak orësh, liderët e BE-së u takuan në Bruksel për një samit të jashtëzakonshëm për të përcaktuar përgjigjen e BE-së ndaj pushtimit. Nuk kishte nevojë për fjalë mes nesh. Veprimi ishte ai që kërkohet. Është një moment në histori që secili prej liderëve të BE-së do ta kujtojë përgjithmonë. Vendimet e marra në këtë mbledhje të Këshillit Evropian sinjalizuan lindjen e BE-së gjeopolitike.

Llogaritja e gabuar e Kremlinit për një luftë të lehtë 3-ditore kundër Ukrainës, duke nënvlerësuar unitetin kolektiv të BE-së dhe vendosmërinë e Ukrainës për të mbrojtur territorin e saj, tregon mashtimin në zemër të udhëheqjes së saj. Kremlini



nuk kujdeset për mirëqenien e njerëzve të tij, prosperitetin e vendit të tyre apo paqen në rajon. Në të kundërt, Ukraina dhe populli i saj kanë rezistuar, kanë rimarrë territoret e pushtuara, kanë shtyrë marinën ruse nga Deti i Zi dhe kanë shkaktuar humbje të mëdha në forcat ruse. Dy vjet pas fillimit të luftës, tani është e qartë se Rusia nuk do të ndalet në Ukrainë ashtu si Rusia nuk u ndal dhjetë vjet më parë në Krime. Rusia vazhdon taktikat e saj destabilizuese – në Moldavi, Gjeorgji, Kaukazin e Jugut, Ballkanin Perëndimor dhe madje edhe më larg në kontinentin afrikan.

Rusia është një kërcënim serioz ushtarak për kontinentin tonë evropian dhe për sigurinë globale.

Nëse nuk e marrim përgjigjen e duhur të BE-së dhe nuk i japim Ukrainës mbështetjen

e mjaftueshme për të ndalur Rusinë, ne jemi të radhës.

Prandaj, ne duhet të jemi të gatshëm për mbrojtjen dhe të kalojmë në një mënyrë “ekonomie luftime”. Është koha për të marrë përgjegjësinë për sigurinë tonë. Ne nuk mund të mbështetemi më tek të tjerët ose të jemi në mëshirën e cikleve zgjedhore në SHBA apo gjetkë.

Ne duhet të forcojmë aftësinë tonë – si për Ukrainën ashtu edhe për Evropën – për të mbrojtur botën demokratike. Një Evropë më e fortë do të kontribuojë gjithashtu në një aleancë më të fortë të NATO-s dhe do të përmirësojë mbrojtjen tonë kolektive.

Ndërsa ne mund të jemi krenarë për atë se sa larg kemi arritur, ka ende shumë më tepër që mund dhe duhet të bëjmë.

Në një telefonatë dy ditë pas fillimit të luftës, presidenti Zel-



ensky iu lut BE-së të dërgonte armë. Së bashku me Përfaqësuesin e Lartë Borrell, ne punuam me liderët e BE-së për të dorëzuar armë vdekjeprurëse në Ukrainë. Kjo ishte e para në historinë e Unionit tonë. Atë fundjavë tashmë, armët e para po arrinin në Ukrainë.

Që atëherë, angazhimi i Evropës ndaj Ukrainës dhe popullit të saj ka qenë i palëkundur në çdo Këshill Evropian.

Ne jemi rritur edhe në frontin ushtarak. Industria e mbrojtjes evropiane ka rritur kapacitetin e saj të prodhimit me 50% që nga fillimi i luftës dhe ne do të dyfishojmë prodhimin evropian të municioneve në mbi 2 milionë predha në vit deri në fund të vitit të ardhshëm.

Ndërkohë në të gjithë kontinentin tonë, propaganda e Kremlinit në Evropë përpiqet të bindë qytetarët tanë se lufta në Ukrainë nuk na shqetëson, se po na shteron buxhetet dhe po na ndan. Këto janë gënjeshtërta flagrante. Ne duhet të bëjmë më shumë për të ndihmuar Ukrainën dhe për të forcuar mbrojtjen tonë evropiane. Ne duhet të jemi në gjendje të flasim jo vetëm gjuhën e diplomacisë, por edhe gjuhën e pushtetit.

Rusia do të shpenzojë një raport prej 6% të PBB-së për mbrojtjen këtë vit, ndërsa BE-ja ende shpenzon mesatarisht më pak se objektivi i NATO-s prej 2% të PBB-së.

Për dekada, Evropa nuk ka investuar mjaftueshëm në sigurinë dhe mbrojtjen tonë. Sot ne përballemi me sfidën më të madhe të sigurisë që nga Lufta e Dytë Botërore, ndaj duhet të ndërtojmë gatishmërinë tonë mbrojtëse. Kjo do të marrë një ndryshim rrënjësor dhe të pak-

në të gjithë kontinentin tonë, propaganda e Kremlinit në Evropë përpiqet të bindë qytetarët tanë se lufta në Ukrainë nuk na shqetëson, se po na shteron buxhetet dhe po na ndan. Këto janë gënjeshtërta flagrante. Ne duhet të bëjmë më shumë për të ndihmuar Ukrainën dhe për të forcuar mbrojtjen tonë evropiane. Ne duhet të jemi në gjendje të flasim jo vetëm gjuhën e diplomacisë, por edhe gjuhën e pushtetit.

thyeshëm në të menduarit tonë, drejt një mendësie strategjike të sigurisë.

Ne duhet t'i japim përparësi Ukrainës dhe gjithashtu të shpenzojmë më shumë, më të zgjuar dhe në një mënyrë më pak të fragmentuar.

Mbështetja e Ukrainës Ndërsa ne rrisim kapacitetin tonë të mbrojtjes, ne duhet të sigurojmë që Ukraina të marrë atë që i nevojitet në fushën e betejës. Ushtarët ukrainas kanë nevojë urgjente për plumba dhe raketa dhe sisteme të mbrojtjes ajrore për të kontrolluar qiejt.

Ne duhet të përdorim buxhetin evropian për të blerë pajisje ushtarake për Ukrainën dhe le të përdorim fitimet e papritura nga asetet e palëvizshme të Rusisë për të blerë armë për Ukrainën. Blini më shumë bashkë

Ne duhet të synojmë të dyfishojmë atë që blejmë nga industria evropiane deri në vitin 2030. Kjo do t'i japë më shumë parashikueshmëri kompanive tona. Kontratat shumëvjeçare gjithashtu do t'i nxisin ata të rrisin kapacitetin e tyre të prodhimit. Kjo do të forcojë industrinë tonë të mbrojtjes, do të rrisë gatishmërinë mbrojtëse dhe gjithashtu do të krijojë vende pune dhe rritje në të gjithë BE-në.

Bëni më të lehtë aksesin në financim Investimet në mbrojtje janë

të shtrenjta, por pa to ne nuk mund të rrisim prodhimin tonë të mbrojtjes. Ne duhet të lehtësojmë mënyrat që industria të ketë qasje më të lehtë në financimin publik dhe privat. Lëshimi i bonove evropiane të mbrojtjes për të mbledhur para për të blerë materiale ose për të investuar në industrinë tonë mund të jetë gjithashtu një mjet i fuqishëm për të forcuar bazën tonë teknologjike, inovative dhe industriale.

Ne gjithashtu duhet të konsiderojmë zgjerimin e mandatit të Bankës Evropiane të Investimeve dhe përshtatjen e politikës së huadhënies për të na lejuar të bëjmë më shumë për të mbështetur industrinë tonë evropiane të mbrojtjes, pra duke ndryshuar përkufizimin e mallrave me përdorim të dyfishtë.

Udhëheqësit e BE-së mblidhen sërish në Bruksel dy vjet pas takimit të rëndësishëm të Këshillit Evropian. Në këtë moment vendimtar në historinë globale, Evropa duhet të jetë e gatshme për mbrojtje dhe të përputhet me urgjencën e kërcënimit. Kjo luftë kërkon udhëheqje të fortë – për të mbledhur njerëzit, bizneset dhe qeveritë tona drejt një fryme të re sigurie dhe mbrojtjeje në të gjithë kontinentin tonë evropian.

Nëse duam paqe, duhet të përgatitemi për luftë.



16 VITE NGA TRAGJEDIA E GËRDECIT

15 Marsi 2024, shënon 16 vjetorin e tragjedisë së Gërdecit, ku 26 persona humbën jetën dhe mbi 300 të tjerë mbetën të plagosur nga shpërthimi në fabrikën e demontimit të armëve në Gërdec.

Paraditen e 15 marsit 2008, në Gërdec 10 km larg Tiranës ndodhi shpërthimi i fabrikës së demontimit të armëve, një shpërthim që u ndje fuqishëm edhe në kryeqytet.

Fillimisht ngjarja u klasifikua si një incident teknologjik, por ende sot pas 16 vjetësh familjarët e viktimave kërkojnë drejtësi.

Familjarët e viktimave kanë vazhduar një betejë të gjatë ligjore, ndërkohë që sipas tyre, përgjegjësit e tragjedisë kanë mbetur ende të pandëshkuar.

Ndërkohë që kanë kaluar vite, familjet e viktimave ende kërko-

jnë drejtësi. Asnjë zyrtar nuk është pas hekurave. Aktualisht gjyqi vijon me të pandehurin, ish-ministrin e Mbrojtjes së kohës, Fatmir Mediu, ndaj të cilit rëndojnë akuzat për “Shpërdorim detyrë” dhe Shpërdorim detyrë” bazuar në kodin ushtarak.

Aktualisht, dosja “Gërdeci” po shqyrtohet në Gjykatën Kundër Krimin të Organizuar dhe Kor-

Dosja “Gërdeci” po shqyrtohet në Gjykatën Kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit ku i pandehur është edhe ish-ministri i Mbrojtjes, Fatmir Mediu. Mediu e konsideroi një proces të manipuluar mediatikisht dhe politikisht hetimin dhe gjykimin për masakrën e Gërdecit.

rupsionit ku i pandehur është edhe ish-ministri i Mbrojtjes, Fatmir Mediu. Mediu e konsideroi një proces të manipuluar mediatikisht dhe politikisht hetimin dhe gjykimin për masakrën e Gërdecit.

Bilanci i shpërthimit në tragjedinë e 15 marsit 2008 në Gërdec ishte tragjik me 26 të vdekur, mbi 300 të plagosur dhe me mbi 100 shtëpi të rrafshuara.

BUJAR SPAHIU RIZGJIDHET NË KRYE TË KMSH-së

“Do të punoj me ngulm për forcimin e ndjenjës kombëtare e atdhedashurisë ndër myslimanët e Republikës së Shqipërisë!”



Bujar Spahiu me 82 vota pro është rizgjedhur për një tjetër mandat 5-vjeçar në krye të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

Zgjedhjet e sotme për kreun e KMSH-së mbahen pas përfundimit të mandatit 5-vjeçar të kryetarit aktual Bujar Spahiu, i zgjedhur më 02 mars të vitit 2019. Tre kandidatët në garë për kreun e KMSH-së ishin kreu aktual Bujar Spahiu, administratori i myftinisë së Durrësit Aduard Shefki, si dhe myftiu i Breatit Emirjon Vathaj. Bujar Spahiu ka arritur të marrë 82 vota nga 92 anëtarë të Kryesisë që kanë votuar në total. Ndërkohë, dy kandidatët e tjerë në garë kanë marrë nga 3 vota secili, ndërsa 4 vota janë shpallur të pavlefshme.

“Të nderuar vëllezër dhe motra kam qenë dhe do të jem i hapur ndaj çdo kritike konstruktive. Ftoj cilindo të shprehë lirisht mendimet

e tyre. Cilido prej jush do të vijojë gjet një atmosferë të mirë të lirisë së shkëmbimeve idesh dhe këshillimi të ndërsjellë sa i shërben qëllimit dhe misionit. Institucioni nuk do ngurojë të ndjek rrugë ligjore ndaj kujtdo që akuzon pa fakte dhe nxit përçarje mes vëllezërve. KMSH do të vijoi të jetë vazhdues i traditës. Në 100 vite kemi qenë faktor stabiliteti paqeje dhe mirëkuptimi në shoqërinë shqiptare. Do vijojë të jetë kontribuues ky institucion në harmoninë dhe dialogun ndërfaqetarak. Do japim kontributin që Shqipëria të jetë më e begatë. Do vijojmë të japim kontributin tonë që të përparojë drejt Evropës. Do bëjmë çmos që familja të jetë e shëndetshme. I lutemi Zotit të jetë krah nesh për ta çuar përpara këtë punë. Le të kthejmë sytë nga Zoti dhe t’i lutemi atij të bëjmë të mirën dhe të refuzojmë të keqen. Amin.”, tha Bujar Spahiu gjatë një fjalimi të mbajtur

pas rizgjedhjes në krye të KMSH-së.

Brenda vetë Komunitetit kanë ndodhur lëvizje, ku Myftiu i Tiranës, Lauren Luli, ka lenë postin e tij dhe është bërë nën/kryetar i KMSH. Ndërsa vendin e tij e ka zënë Gazment Teja.

Nga KMSH-ja ndërkaq deklarohet se zgjedhjet janë bërë duke filluar që në qershor.

“Në muajin qershor janë bërë zgjedhjet nëpër xhami. Pastaj zgjedhjet në Myftini ku çdo xhami ka pasur një përfaqësues. Është krijuar Këshilli i Myftinisë i cili ka zgjedhur anëtarin e Këshillit të Përgjithshëm, qe është këtu sot për të votuar. Zgjedhjet janë bërë konform çdo rregulli statutor”, shkruhet në një reagim të tyre.

Pas ceremonisë së betimit, anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm e uruan z. Spahiu për mandatin e dytë në krye të institucionit.

Protesta para Medresesë

Këto zgjedhje para dhe pas zhvillimit të tyre u mbajtën mes akuzave dhe polemikave se Komuniteti Mysliman i Shqipërisë është i kapur nga njerëzit e Fetullah Gylenit, ose siç e konsiderojnë ata, organizata FETO. Për këtë një pjesë e besimtarëve mysliman i konsiderojnë zgjedhjet e sotme si “një teatër të orkestruar”.

Ata kanë protestuar ditën e sotme jashtë Medresesë së Tiranës, ku me pankarta në duar i kanë bërë thirrje që gylenistët të largohen nga KMSH-ja. “Të largohen gylenistët nga pushtimi i KMSH-së”, “FETO Leave Albanian Islam Alone”, “Legjitimitet për KMSH-në”, “Gylenistë ne nuk iu duam”,

ishin disa prej pankartave që mbanin ata në duar.

Në fakt ndërsa ky grupim i vogël besimtarësh akuzojnë përfaqësinë legjitime të KMSH-së se janë nën influencën e Gulenit, duket se vetë grupim është nën influencën e Erdoganit. Madje dhe pankartat në gjuhën huaj ishin pikërisht për ti dhënë jehonë këtij pretendimi përtej kufijve të Shqipërisë.

Kjo proteste e ditës së sotme vjen pak ditë pas tensioneve brenda xhamisë Dine Hoxha në Rugën e Kavajës ku besimtarët ofenduan myftiun e Tiranës Laurent Lulin dhe tentuan ta përzhënë. Si mundet që këta besimtarë të përzhënë dhe të ofendojnë një klerik mysliman. Në emrin e cilës fe ndodh ky

përçudnim, apo në emër të Erdoganizmit?

Duhet thënë se pikërisht Presidenti turk, Recep Tayyip Erdoğan, prej vitesh po i kërkon kryeministrit Edi Rama, atë që ai e cilëson si “pastrim i mbetjeve të fundit të organizatës FETO”, të klerikut Fetullah Gylen, të cilin e akuzon për veprimtari terroriste dhe si përgjegjëse të grushtit të dështuar të shtetit në vitin 2016. Këtë kërkesë ia përsëriti edhe në vizitën e fundit zyrtare në Ankara më 20 Shkurt të 2024.

Pjesë e agjendës sonë ishte dhe pastrimi i mbetjeve të FETO në Shqipëri, e cila vazhdon aktivitetet e saj me qëllim për të hedhur hije mbi marrëdhëniet tona. Ne nuk do të lejojmë që kjo t’ia arrijë objektivat e saj dhe po ashtu ne shikojmë që edhe autoritetet shqiptare janë të vetëdijshme për këtë. Lufta jonë me këtë strukturë do të vazhdojë dhe falënderoj për kontributin që ka dhënë në arsimin fondacioni turk Maarif në Shqipëri” – theksoi Erdogan.

Peng i kësaj kërkesë ka mbetur xhamia e Namazgjasë në Tiranë, e investuar nga Turqia, e cila edhe pse ka mbaruar prej kohësh, ende nuk është inaguruar, për shkak se Presidenti turk Erdogan i kërkon kryeministrit Rama pastrimin e KMSH nga organizata “FETO”. Megjithatë, kjo xhami i përket Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, dhe është në territorin shqiptar, një vend Sovran dhe Demokratik i cili në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk duhet të bie pre e kufizimeve të askujt. Është e papranueshme që në emër të fesë, për interesa personale, të krijohen përçarje dhe ndasi. Përkundrazi në emër të fesë duhet dhënë shembëlltyra tolerance, paqeje dhe bashkimi.

Presidenti turk, Recep Tayyip Erdoğan, prej vitesh po i kërkon kryeministrit Edi Rama, atë që ai e cilëson si “pastrim i mbetjeve të fundit të organizatës FETO”, të klerikut Fetullah Gylen, të cilin e akuzon për veprimtari terroriste dhe si përgjegjëse të grushtit të dështuar të shtetit në vitin 2016. Këtë kërkesë ia përsëriti edhe në vizitën e fundit zyrtare në Ankara më 20 Shkurt të 2024.



SERBIA DHE SFIDA E STABILITETIT TË MALIT TË ZI



“Serbia kërkon zgjerim territorial e sidomos dalje në det me një politikë imperialiste dhe objektiv kryesor ka Malin e Zi”, shkruan ndër të tjera në analizën e tij për Institutin “Octopus“, eksperti i Octopus, DR. Gurakuç Kuçi* Analiza e tij e titulluar “Rreziqet dhe rikonfigurimet gjeopolitike: Serbia dhe sfida e stabilitetit të Malit të Zi” tregon se “partitë e orientimit pro-rus dhe pro-serb”, të cilat kanë qenë të pranishme në disa nga kombinimet në qeverinë e Malit të Zi që nga viti 2020, “duke bashkëpunuar edhe me Kishën serbe ndjekin në mënyrë të

prerë përpjekjen e Beogradit për të ndryshuar struktura etnike në këtë vend”.

Në konkluzionet e kësaj analize, DR. Gurakuç Kuçi thekson:

Gjeografia është një faktor kyç në përcaktimin e fatit të një vendi. Në skenën ndërkombëtare, vende të vogla por të pozicionuara strategjikisht si Mali i Zi janë të përfshirë në sfida të mëdha dhe janë nën presionin e fqinjëve të tyre me mendje imperialiste. Serbia, me një histori të madhe hegjemoniste rajonale, mbetet e vendosur në rrugën e saj, duke mos u përpjekur të ndryshojë edhe pse pers-

pektiva e vendeve të Ballkanit Perëndimor ndaj Perëndimit është aty. Edhe pse Mali i Zi ka vazhduar rrugëtimin e tij drejt strukturave perëndimore deri në vitin 2020, ai tani është sfiduar nga partitë me orientim pro-rus dhe pro-serb. Kjo, në bashkëpunim me Kishën Ortodokse Serbe, ka paralajmëruar sfera të reja ndikimi, ndërhyrje e cila u theksua së fundmi me përpjekjen për ndryshimin e strukturës etnike në Mal të Zi nga Serbia.

Përtej kësaj, Serbia, në kërkim të zgjerimit territorial dhe daljes në det, me një politikë imperialiste, ka si objektiv

kryesor Malin e Zi. Ndërkohë, ndihmat ruse po rrisin presionin përmes luftës hibride, duke përdorur metoda të ndryshme për të arritur qëllimet e tyre. Këtu përfshihen: – vrasjet politike si p.sh. atentati ndaj Gjukanoviçit për ndryshimin e qasjes së Malit të Zi dhe ndalimin e anëtarësimit të tij në NATO. – partitë politike, duke mbështetur subjekte të ndryshme, kryesisht të ekstremit të djathtë, duke shfrytëzuar brishtësinë e demokracisë dhe duke legalizuar çështjen e tyre etnike. – zgjedhjet zgjedhore duke krijuar sa më shumë subjekte të cilat më pas arrijnë të ndajnë votat e partive të mëdha që nuk janë në interesin pro serb dhe rus. – ndikim përmes propagandës së ndryshimit si ato para regjistrimit që përmendëm në punim.

“Mali i Zi, një ent i vogël, por me një vendndodhje unike dhe të rëndësishme, me dalje në detin Adriatik, është vendosur në qendër të një loje të madhe gjeopolitike ndërkombëtare”, thuhet në shkrim. Ndihma ruse për Serbinë në këto përpjekje rrit presionin përmes luftës hibride, duke përdorur metoda të ndryshme për të arritur qëllimet e saj.

Nëse lufta hibride e Rusisë dhe Serbisë nuk ndalet, opsionet e mundshme për Malin e Zi janë pesë:

Opsioni 1. “Maqedonia e Veriut”. Serbët në Mal të Zi – si shqiptarët në Maqedoninë e Veriut – do të kenë të drejta më të mëdha për gjuhën e tyre dhe më e rëndësishm-

ja – përfaqësim më të madh dhe të garantuar në të gjitha nivelet dhe në të gjitha strukturat e pushtetit.

Opsioni 2. “Bosnje-Hercegovina”. Ky opsion parashikon federalizimin e Malit të Zi, duke përfshirë ndryshimin nga një sistem unitar në një sistem federal, si dhe krijimin e autonomisë serbe.

Opsioni 3. “Kosova” – Ky opsion parasheh që të krijohet një Asociacion për komunën me shumicë serbe me kompetenca ekzekutive.

Opsioni 4. “Referendumi”. Ky opsion tenton të kthehet nën Serbinë në të njëjtën formë si



Lufta hibride dhe përpjekjet për ndikim po nxisin tensionet në rajon, duke krijuar një atmosferë të pasigurt dhe sfiduese, veçanërisht për Malin e Zi dhe të gjithë Ballkanin Perëndimor. Ky realitet i krijuar nga Rusia dhe Serbia mund të ndryshohet vetëm me një përfshirje të fortë të komunitetit ndërkombëtar, me theks të veçantë në NATO, SHBA dhe BE. Është koha që të ndalet “politika e zbutjes” ndaj Serbisë dhe të përqendrohet vëmendja drejt veprimeve agresive, siç ishte akti i dhunshëm në Banjaskë të Kosovës në shtator 2023 dhe ndërhyrjet e vazhdueshme në Bosnje dhe Mal të Zi.

u shpall shteti i Malit të Zi, qoftë si bashkim ose si bashkim i plotë.

Opsioni 5. “Rrethanat gjeopolitike”. Serbia mund të presë dhe të ngadalësojë të gjitha proceset në Ballkanin Perëndimor derisa të ndryshojnë rrethanat gjeopolitike dhe ekuilibri i forcave, ndoshta në favor të Rusisë dhe Kinës, ku si rezultat mund ta marrë lirisht Malin e Zi me ose pa luftë.

Lufta hibride dhe përpjekjet për ndikim po nxisin tensionet në rajon, duke krijuar një atmosferë të pasigurt dhe sfiduese, veçanërisht për Malin e Zi dhe të gjithë Ballkanin Perëndimor. Ky realitet i krijuar nga Rusia dhe Serbia mund të ndryshohet vetëm me një përfshirje të fortë të komunitetit ndërkombëtar, me theks të veçantë në NATO, SHBA dhe BE. Është koha që të ndalet “politika e zbutjes” ndaj Serbisë dhe të përqendrohet vëmendja drejt veprimeve agresive, siç ishte akti i dhunshëm në Banjaskë të Kosovës në shtator 2023 dhe ndërhyrjet e vazhdueshme në Bosnje dhe Mal të Zi. Vetëm përmes një qasjeje të përbashkët dhe vendosmërisë së përbashkët komuniteti ndërkombëtar mund të ndalojë përhapjen e ndikimit dhe destabilizimin e rajonit. Shembulli i Putinit dhe Hitlerit dëshmon se sa e pavlefshme është “politika e qetësimit” me diktatorët nazi-fashistë.

***Analiza e plotë e publikuar në origjinal për Institutin “Octopus”**



580-VJETORI I BESËLIDHJES SË LEZHËS

Presidenti Begaj pret delegacionin arbëresh: Bashkimi është forca përballë çdo kërcënimi

Presidenti Bajram Begaj priti më 2 Mars në një takim një delegacion të gjerë arbëreshësh nga Italia për kremtimin e 580-vjetorit të Besëlidhjes së Lezhës.

Kreu i shtetit ftoi për këtë kremtim drejtues të bashkive dhe komunave ku jetojnë arbëreshët, personalitete të kulturës, sipërmarrës dhe drejtues të shoqatave që kanë luajtur një rol të rëndësishëm për komunitetin arbëresh në Itali.

Është hera e parë që një President ndërmerr iniciativën për mbledhjen e arbëreshëve në ceremoninë e nderimit të Besëlidhjes së 2 Marsit 1444, si një mesazh për nevojën e unifikimit mes shqiptarëve përballë sfidave të sotme.

“Mirë se erdhët në shtëpinë tuaj! Ky është institucioni i Presidentit të Republikës dhe ju jeni në shtëpinë tuaj. Është kënaqësi t’ju pres sot në Shqipëri. Jemi vend i vogël po me zemër të madhe. Kemi bujarinë, mikpritjen, vlera të njëjta me atë të Italisë mike e cila u bë shtëpia juaj e re 6 shekuj më parë, ndërsa për shqiptarët e pas viteve ‘90 Italia, është shtëpia e dytë për ta”, u shpreh Begaj gjatë pritjes në Presidencë.

“580 vite më parë Heroi Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe të gjithë përfaqësuesit nga krahnat e ndryshme shqiptare u bashkuan dhe dhanë besën në ditë të vështira për të përballuar sfidat e ndryshme të kohës. Sot është një



ditë e veçantë për ta kujtuar atë moment për faktin se sfidat tona të reja përballohen së bashku jo vetëm për ne si bashkëatdhetarë e patriotë por edhe me partnerët tanë”, tha Begaj.

“Po jetojmë kohë të vështira. Sapo dolëm nga një periudhë e pandemisë.

Luftë është duke vazhduar në Ukraine, situatë jo e këndshme në Lindjen e Mesme dhe kjo kërkon që ne të jemi bashkë për të zgjidhur gjërat.

Mendoj se sot është ditë e veçantë edhe për të falënderuar Italinë mike, pasi që ju dha mundësinë juve, parardhësve tuaj të mbani gjallë vlerat e shqiptarisë, kulturën, identitetin, gjuhën. Italia mike ka qenë afër Shqipërisë në periudha të vështira të saj. Dhe aktualisht është avokatja më e mirë e Shqipërisë për rrugëtimin e anëtarësimit të saj në BE.

Marrëdhëniet shumë të mira

politike janë përkthyer në marrëdhënie shumë të mira ekonomike” – u shpreh Presidenti i Republikës.

“Ju falënderoj shumë që jeni pjesë e këtij gëzimi të ditës së sotme.

Në shenjë të kësaj vizite kam përgatitur një dhuratë: një monedhë që përfaqëson Shqipërinë. Nga nga njëra anë është Shqiponja e Skënderbeut, nga ana tjetër ka një shtëpi që gjendet në malet në Veri të Shqipërisë. Me këtë duke ju referuar një proverb të vjetër tonin: “ Shtëpia e Shqiptarit është e Zotit dhe e mikut” ju ftoj edhe një herë të shijoni këtë vizitë e të ndjeheni si në shtëpinë tuaj” – përfundoi mesazhin e tij Presidenti i Republikës.

Nga Lezha, Presidenti Bajram Begaj e cilësoi Besëlidhjen e Lezhës si dëshmi e unitetit, guximit për liri dhe shembull të qëndrësës në fjalën e mbajtur në ceremoninë e



kremtimit të 580-vjetorit të kësaj ngjarjeje madhore historike në Lezhë.

“580-vjetori i Besëlidhjes së Lezhës shënon një prej momenteve më të rëndësishme të historisë sonë mbarëkombëtare. 2 Marsi 1444 qëndron si dëshmi e unitetit, guximit dhe përkushtimit të shqiptarëve për liri e pavarësi. Nën udhëheqjen e Gjergj Kastrioti – Skënderbeut ne mbetëm të gdhendur në kronikat më të rëndësishme evropiane të kohës e shekujve më pas, si shembull i qëndresës dhe guximit për të gjithë Evropën”, u shpreh Presidenti Begaj.

Sipas Presidentit, bashkimi i shqiptarëve në Lezhë 580 vjet më parë mbetet një lajtmotiv evropian i qëndresës së përbashkët

kundër çdo agresioni.

“Sot, faktori shqiptar në Ballkan vijon të luajë rol thelbësor në paqen dhe orientimin perëndimor të rajonit. Në kushtet e sotme gjeopolitike, ku sfidat dhe kërcënimet ndaj sovranitetit të popujve, përfshi atyre të Ballkanit, dhe integritetit territorial evropian, janë aktuale, veçanërisht për shkak të agresionit rus ndaj Ukrainës, Besëlidhja e Lezhës e roli i historik i shqiptarëve marrin një rëndësi të veçantë”, shtoi ai.

“Ato na kujtojnë se bashkimi dhe solidariteti janë thelbësorë për mbrojtjen e vlerave të përbashkëta dhe të lirisë. Ato na mësojnë se përballë sfidave nuk mund të qëndrojmë të ndarë, por vetëm të bashkuar”, u shpreh Presidenti Begaj.

Presidenti u ndal edhe tek historia e arbëreshëve dhe përpjekjeve të tyre për të ruajtur identitetin kombëtar.

“Arbëreshët, duke ruajtur gjuhën, zakonet dhe kulturën shqiptare, janë dëshmi e gjallë e bashkimit dhe forcës së identitetit shqiptar që mbijeton pavarësisht kufijve dhe kohës. Ata tregojnë se edhe larg dheut amë, zemra shqiptare rreh me të njëjtin ritëm të guximit dhe ndershmërisë, të krenarisë dhe respektit për

tjetrin”, tha Begaj.

“Prania e tyre këtu sot, për të festuar së bashku, është simbolikë e një ure që lidh të kaluarën me të tashmen, duke i dhënë kuptim të ardhmes sonë. Akti i Besëlidhjes dhe shembulli i arbëreshëve na kujtojnë se bashkimi është forca që çdo ëndërr për liri dhe prosperitet e bën të mundur dhe të pashmangshme”, shtoi Presidenti. “Ne kemi detyrë të mbajmë gjallë historinë tonë, ku Besëlidhja e Lezhës qëndron si kujtesë e dashurisë për lirinë dhe njëri-tjetrin”, u shpreh ai.

Begaj shfrytëzoi momentin për të theksuar në këtë ditë të shënuar të historisë shqiptare, rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit me NATO-n dhe vijimit me bindje të rrugëtimit tonë drejt integritetit plotë në BE.

“Padyshim që duhet të jemi të vetëdijshëm për sfidat me të cilat shqiptarët përballen brenda vendit e kudo në rajon, por le të mos harrojmë se një ditë si kjo e sotmja provon aftësinë tonë për të adresuar çdo sfidë”, tha Begaj.

“Me orientimin tonë të palëkundur evropian, le të vijojmë të ndërtojmë mbi themelet e shëndosha të vendosura 580 vjet më parë, duke qenë gjithmonë të gatshëm të përqafojmë ndryshimet demokratike”, vijoi ai.

“580-vjetori i Besëlidhjes së Lezhës është një ftesë sa historike, aq dhe aktuale për të ripërsëritur përkushtimin tonë ndaj kombit shqiptar. Mbi të gjitha, le të përulemi me mirënjohje dhe të nderojmë sakrificat e atyre që para nesh u angazhuan për atdheun që ne gëzojmë sot e të ecim në rrugën që ata çelën: rrugën e lirisë, pavarësisë dhe dinjitetit mbarëkombëtar”, përfundoi Presidenti Bajram Begaj.



Leyen dhe stabilokracia! Polonia rikthehet në Euro-Atlantizëm ! Tripalëshi i Vajmarit në Berlin! ”Jo murit me kokë, Albin”!

REALPOLITIK FLASH NR. 89

| 1 - 16 MARS 2024

| EKSKLUZIVISHT PËR ARGUMENTUM

Mbi 4 ngjarjet kryesore diplomatike, shkurt dhe shqip, me vetëm 1.000 fjalë nga analisti i njohur,



DR. JORGJI KOTE *GRAND MASTER*

1.

Leyen dhe stabilokracia! Më 9 Mars, Grupimi më i madh politik i Partive të Djathta Europiane (EPP) në Parlamentin Europian miratoi me shumicë votash Presidentin e Komisionit Europian, Ursula von der Leyen si kandidat kryesore në zgjedhjet europiane më 6 dhe 9 Qershor për një mandat të dytë pesëvjeçar. Me vlerësime pozitive për aftësitë dhe rezultatet e saj në krye të Komisionit në

momente tejet të vështira për BE-në; njihen tashmë disa nis-ma epokale me rastin e krizës



së koronës dhe agresionin rus ndaj Ukrainës.

The President of the European Commission Ursula von der Leyen prepares to address

the audience during a plenary session at the European People Party (EPP) Congress in Bucharest, Romania, on March 7, 2024. (Photo by Daniel MIHAILESCU / AFP)

